REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.49, datë 16/09/2005

PËR
MIRATIMIN DHE FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT "KONTRIBUTI I MJEKSISË KLINIKE NË SIGURIMIN E DHURUESVE VULLNETARË TË GJAKUT".

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit Nr.9355, dt.10/03/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.636, dt.30/09/2004 "Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik" pika 4.9, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë projektin **"Kontributi i mjekësisë klinike në sigurimin e dhuruesve vullnetarë të gjakut".**

2. Të miratojë fondin prej **100 000 lekë**, për financimin e pjesshëm të këtij projekti.

3. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të Buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", nga zëri "Projekte sociale".

4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI